

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Detaje të reja - I martuar me një grua ruse, si u kap gafil elbasanlliu Salvatore Aliu, që kërkohej nga SPA K
ADRESA	https://www.syri.net/kronike/919531/i-martuar-me-nje-grua-ruse-si-u-kap-gafil-elbasanlli-u-salvatore-aliu-qe-kerkohej-nga-spak/
BURIMI	syri.net
GJENDJA	online

KOHA


KAPUR NGA NE	27 shtator 2026, 16:14:38 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	27 shtator 2026, 16:06:27 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	2acb8111352153052f8879daaa77da1ce798b14c40f5fc846f369dcf6f34e83c
TEKSTI	c790218c6b927fb4043f9c1fc144ac5bcff98fb24f8bcd42f427ac2411cb4589
PAMJA	8ce30d1a6cb80ea75858ef019674fcefc30a3446cf18e98a2870ca76bd153a1

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	91f573e0feab7d0c0f2d9b4ac56f7e56cc7b10cd6367107a4c4fff43972664f1
E MËPARSHMJA	—
RRËNJA MERKLE	9c79dfe18abd067ab8b189d0d92c4d66095ab349897e5facabd5b8506753a66f
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahase hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/91f573e0feab7d0c0f2d9b4ac56f7e56cc7b10cd6367107a4c4fff43972664f1>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

**FATMIR MEDIU**

Rama heshti për Kosovën në OKB, nuk iu kundërvu Vuçiçit dhe zgjodhi të flasë për Diellën

**NDRIÇIM KULLA**

Dorëheqja e Ramës, kërkesë edhe e ndërkombëtarëve

LAJMI I FUNDIT

SYRI I BOTËS/ Deti i kuq dhe nafta 'e zezë' shqiptare



më të lexuarat

Aksidenti tragjik në Fushë-Krujë, Forcat e Armatosura në zi për 19-vjeçarin: Ishte student i Akademisë

FOTO/ Shqiptarët arratisen me një BMW X6 të vjedhur, aksidentojnë tre makina dhe plagosin një polic

Zjarret/ Në qarkun Lezhë u dogjën 2500 hektarë pyje dhe 12 banesa

'Porositësit e ushqimit'/ Lushnje, arrestohen shitësit e kokainës, e shpërndanin me motora

EMRAT/ Plagosën të riun pas sherrit për riparimin e makinës, shpallen në kërkim babë e bir

Atentati në Athinë/ Lokali në pronësi të Denis Lulit, urdhri dyshohet të jetë dhënë nga Klod Cara

I martuar me një grua ruse, si u kap gafil elbaskanlliu Salvatore Aliu, që kërkohej nga SPAK

18:06, 27/09/2026

ZMADHO TEKSTIN



Elton Qyno - Syri.net

Detaje të reja kanë dalë nga operacioni, për kapjen në Rusi të Salvatore alias Shpëtim Aliut në Federatën Ruse, ku Interpol Moskë ka njoftuar Interpol Tiranën, se kishte ndaluar një person Shqiptar i lançuar në sistem me pullë të Kuqe për "trafik droge" dhe "organizatë kriminale".

Mësohet se Shpëtim Aliu, pas problemeve që pati me Drejtësinë Shqiptare në muajin qershor 2026 është larguar nga Dubai në drejtim të Moskës në Rusi, me shpresën për ti shpëtuar një arrestimi të mundshëm nga autoritetet e Dubait dhe ekstradimit më pas në Shqipëri, siç ka ndodhur me rastet e tjera.

Aliu ka shfrytëzuar këtë lëvizje për shkak të lidhjeve që ka pasur me një shtetase Ruse, më të cilën edhe është martuar. Ai kishte vendosur të jetonte në këtë shtet përmes kamoflinit dhe strehimit nën petkun e gruas.

Por me sa duket identifikimi i kësaj gruaje, ka sjellë më pas dhe zbulimin e vendodhjes së bashkëshortit të saj, Salvatore alias Shpëtim Aliu, i cili është kapur gafil nga policia Ruse.

Pas kapjes së tij në Rusi, tashmë prokuroria e posaçme SPAK ka dërguar letërporosi përmes ministrisë së Jashtme në Federatën Ruse, me qëllim ekstradimin e Aliut në Shqipëri.

Aliu, u shpall në kërkim nga SPAK në muajin qershor të këtij viti, pasi akuzohet sipas hetimeve se ka pasur një rol kyç në një rrjet ndërkombëtar të trafikimit të

kokaines.

Sipas dosjes hetimore të SPAK, Salvatore Aliu, dyshohet se ka pastruar në Shqipëri të paktën 30 milionë euro, të siguruara nga aktivitetet kriminale.

Një rol të rëndësishëm në menaxhimin e parave dyshohet se ka pasur vëllai i tij, Isa Aliu, i cili rezultoi të ketë në pronësi katër kompani, të përdorura, sipas hetimeve, për investime në pasuri të paluajtshme, vila, apartamente, troje dhe ndërtime, përfshirë struktura hoteliere në zona turistike.

Në qershor 2026, Gjykata e Posaçme Kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar ka caktuar ndaj Aliut masën e sigurisë "Arrest në burg", për veprat penale "Trafikimi i narkotikëve", "Pastrimi i produkteve të veprës penale ose veprimtarisë kriminale", "Grupi i strukturuar kriminal" dhe "Kryerja e veprave penale nga organizata kriminale dhe grupi i strukturuar kriminal".

Sipas hetimeve, Salvatore Aliu, përdorte platformën e komunikimit SKY dhe identifikoi me disa emra, mes tyre "Dala", "Qero", "Qerosi", "Viktor" dhe "Albo Pelon".

Në një komunikim të gushtit 2020 me vëllain e tij, Isa Aliu e informon se kishte në dispozicion 6 milionë euro. Dy javë më vonë, Salvatore Aliu e njofton se priste të merrte edhe 20 milionë euro të tjera.

Në komunikimet e zbardhura nga hetuesit, ai dyshohet se i jepte të vëllait udhëzime se si të fshiheshin paratë deri në momentin e investimit të tyre. Ndër sugjerimet ishte edhe vendosja e parave në fuçi 50-litërshe dhe groposja e tyre.



© SYRI.net

Lexo edhe:



Vlorë/ Theu xamin dhe vodhi kasën e supermarketit, arrestohet 32-vjeçari



Zjarri përfshin një hotel pranë pedonale në Shkodër



Shkodër, 2 të arrestuar dhe 13 të proceduar në një javë nga Policia Rrugore

Vrasja në Tiranë/ Zbardhet dëshmia e autorit: U zëmë me fjalë, e godita disa herë me thikë në bark

Rodos/ Shqiptari i merr 15 mijë euro polakes dhe e kërcënon me fotot nudo

Detaje tronditëse/ Ergys Agasi mori të dhënat e telefonave të 'zbërthyer' nga policia

TË NGJASHME



Në kërkim nga drejtësia italiane dhe kosovare, arrestohen dy persona në Shqipëri



Maliq/ Kapet duke transportuar emigrantë, arrestohet një shtetas



Fier/ Automati në banesë, arrestohet 66-vjeçari - gjendet edhe një 'Benz' i trafikuar nga Britania



VIDEO - Kakavijë/ Kapet 'ngarkesa' prej 91 kg kanabis, në pranga çifti i bashkëshortëve

Gjykata e Posaçme cakton arrest me burg për Beldar Cadin

VIDEO/ Furnizonin më drogë shkollat e Tiranës - Mes 31 të arrestuarve edhe një ish-efektiv policie

Nëntë të arrestuar për krime lufte në Zubin Potok lidhur me rastin e 'Grupit të Intelktualëve'

[LAJME](#) [POLITIKE](#) [KRONIKË](#) [EKONOMI](#) [KOSOVA](#) [BOTË](#) [KULTURË](#) [SHKENCË](#) [SPORT](#) [JETË/STIL](#) [TRASHËGIMI](#) [MIEDIS](#) [ARKIVA](#)



SYRI.net është agjencia më e madhe e lajmeve në Shqipëri, që brenda një kohe të shkurtër është kthyer në lider të informacionit. Në SYRI.net do të gjeni opinionistë më me emër në vendin tonë, investigime dhe lajme që nuk do ti gjeni diku tjetër. Lajmet në SYRI.net janë prodhim i SYRI.net dhe nuk lejohet marrja e tyre pa një komunikim të mëparshëm me redaksinë. Ju ftojmë të klikoni dhe të na shkruani sa herë që ju mendoni se duhet. Stafi i SYRI.net

Për informacione info@syri.net, për reklama marketing@syri.net

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.